



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë

Me datë: 14.06.2022

1	Fjolla Mjeku	Qëndrimet e mësimdhënësve rreth sfidave të mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Teuta Danuza	
2	Nazife Preniqi	Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ në rritjen e performancës akademike të nxënësve në klasën inkluzive	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Hatixhe Ismajli	
3	Enedia Kallaba	Qëndrimet e mësimdhënësve të shkollës fillore për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në klasa gjithëpërfshirëse	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Majlinda Gjellaj	
4	Alberita Tahiri	Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj çrregullimeve emocionale e të sjelljes dhe efektit të tyre në të nxënë	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Teuta Danuza	
5	Remzije Hajdini	Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me testin e maturës të lëndëve profesionale në raport me ato të përgjithshme	Kryetar/e	Demë Hoti	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Blerim Saqipi	
6	Valentina Abdullahu	Sfidat e përfshirjes aktive të fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione parashkollore	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
			Mentor/e	Naser Zabeli	
			Anetar/e	Rozafa Shala	
7	Ferdeze Agaj	Cilësia e trajnimeve në qendrat për aftësim profesional dhe ndikimi i tyre në tregun e punës	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Teuta Danuza	
			Anetar/e	Demë Hoti	
8	Mimoza Musa Selmani	Bashkëpunimi mësimdhënës-prind: Përmirësimi i sjelljes dhe suksesit në shkollë të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Ardita Devolli	
			Anetar/e	Teuta Danuza	
9	Merita Keqmezi	Faktorët që ndikojnë në motivimin e mësimdhënësve në shërbim për zhvillim profesional të vazhdueshëm	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Hatixhe Ismajli	
10	Fisnik Krasniqi	Niveli i zhvillimit të njohurive, shkathtësive dhe vlerave tek studentët absolutentë në universitetet të cilat përgatisin mësimdhënës	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Naser Zabeli	
11	Mirjeta Rexha	Bashkëpunimi familje-edukatore përkitazi me punën me fëmijët me sjellje agresive	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Ardita Devolli	
			Anetar/e	Teuta Danuza	

1. FJOLLA MJEKU

“Qëndrimet e mësimdhënësve rreth sfidave të mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse”

Komisioni:

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor

Prof. Ass. Arlinda Beka, kryetare

Prof. Ass. Teuta Danuza, anëtare

Abstrakti

Rëndësia e kësaj teme është e madhe, sepse merren për bazë qëndrimet e mësimdhënësve rreth klasave gjithëpërfshirëse. Zgjedhja e këtij lloji të hulumtimit është bërë për të rritur nivelin e kuptueshmërisë mbi rëndësinë e qëndrimeve të mësimdhënësve në klasën gjithëpërfshirëse dhe sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit në klasë gjithëpërfshirëse.

Qëllimi i këtij studimi ishte, që të identifikojë qëndrimet e mësimdhënësve të shkollave fillore rreth sfidave të mësimdhënies në klasat gjithëpërfshirëse. Metodologjia e këtij hulumtimi është sasiore (pyetësi me mësimdhënës) dhe cilësore (intervista). Katër nga pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë: Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve rreth sfidave të mësimdhënies gjithëpërfshirëse? Cilat janë aspektet më kryesore të punës së mësimdhënësve në klasën gjithëpërfshirëse? Cilat janë aspektet më kryesore të punës së mësimdhënësve në klasën gjithëpërfshirëse? Cili është dallimi në mes qëndrimeve të mësimdhënësve të klasave të shkollës fillore dhe asaj të mesme të ulët?

Hulumtimi është realizuar në shkollat e Republikës së Kosovës. Për mbledhjen e të dhënave do të përdoret pyetësi dhe intervista. Pyetësi është realizuar me 100 mësimdhënës të shkollave fillore klasat I-V dhe 100 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta klasat VI-IX, ndërsa në intervistë janë përfshirë 5 drejtor të shkollave.

Mësimdhënësit kanë qëndrime pozitive lidhur me gjithëpërfshirjen, por kemi edhe mësimdhënës që nuk e përkrahin, duke u arsyetuar se kanë pak njohuri për punën me nxënës me nevoja të veçanta. Shumica e mësimdhënësve përkrahës të gjithëpërfshirjes janë shprehur se socializimi në mes të nxënësve ndikon më shumë në mirëqenien e këtyre nxënësve dhe në të nxënit në bashkëpunim me nxënësit tjerë.

Mangësi e gjithëpërfshirjes sipas mësimdhënësve është infrastruktura shkollore jo adekuate, mungesa e trajnimeve nga mësimdhënësit për këtë problem, rastet e rënda të nxënësve me nevoja të veçanta të cilat paraqesin problem në menaxhimin e klasës.

Aspektet kryesore të punës së mësimdhënësve në klasën gjithëpërfshirëse janë: Hartimi i Planit Individual të Arsimit (PIA), puna e individualizuar me këta nxënës, përdorimi i strategjive më të përshtatshme të mësimdhënies, vlerësimi i veçantë, përkrahja e vazhdueshme etj.

Kemi ardhur në përfundim se mësimdhënësit kanë qëndrime pozitive rreth gjithëpërfshirjes dhe janë të gatshëm të përballen me sfidat në klasat gjithëpërfshirëse.

Fjalët kyçe: Klasa, mësimdhënia, sfidat, qëndrimet e mësimdhënësve, gjithëpërfshirja.

2. NAZIFE PRENIQI

“Ndikimi i teknikave të vlerësimit formativ në rritjen e performancës akademike të nxënësve në klasën inkluzive ,,

Komisioni:

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor

Prof.as. Ardita Devolli, kryetare

Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli, anëtare

Abstrakti

Shkollat dhe mësimdhënësit duhet të praktikojnë një sistem të drejtë, të besueshëm dhe transparent të vlerësimit. Dy dokumente të rëndësishme që i ndihmojnë shkollat në përmbushjen e detyrave të tyre me përgjegjësi, në lidhje me vlerësimin, janë Kodi i Etikës për Vlerësim si dhe Standardet e Vlerësimit.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojmë rëndësinë dhe efektet që kanë teknikat e vlerësimit formativ në rritjen e performancës akademike të nxënësve në klasën inkluzive.

Ky hulumtim ka për qëllim për të argumentuar ndikimin e teknikave të vlerësimit për nxënie në ngritjen dhe përmirësimin e rezultateve në klasë.

Metodologjia e këtij hulumtimi është metodologji mikse, cilësore -(vëzhgim i punës në klasë) dhe sasiore (pyetësori me nxënës dhe mësimdhënë). Zgjedhja e këtij lloji të hulumtimit është bërë për të kuptuar rëndësinë dhe efikasitetin e përdorimit të teknikave të vlerësimit formativ për rritjen e performancës së nxënësve në klasë. Pyetjet kërkimore të këtij hulumtimi janë:

Çfarë ndikimi kanë teknikat e vlerësimit formativ në rritjen e performancës akademike të nxënësve në klasën inkluzive?

Cila prej teknikave ka ndikim më të madh në rritjen e performancës së nxënësve? Ky hulumtim është realizuar me nxënës të klasave inkluzive të shkollës fillore të mesme të ulët " Ibrahim Rugova " në Obiliq, me klasat III/1 që i ka 24 nxënës, klasat IV /1 që i ka 20 dhe kl.V/2 me 23 nxënës me gjithsej 67 nxënës dhe 10 mësimdhënë.

Për grumbullimin e të dhënave është përdorur lista e vëzhgimi dhe pyetësori. Pyetësori është realizuar me 10 mësimdhënëse kurse në vëzhgim janë përfshirë një klasë e tretë një e katërt dhe një e pestë (nxënësit e shkollës së dytë të kurrikulës).

Rezultatet nga ky hulumtim tregojnë se përdorimi i këtyre teknikave ndikon në bashkëpunim të mirë në mes të nxënësve dhe qëndrueshmërinë e njohurive gjithashtu informatat kthyesë gjatë procesit të mësimnxënies ndikojnë në ngritjen e rezultateve të nxënësve. Vështirësitë të cilat u paraqitën gjatë zgjidhjes së detyrave, nxënësit i përmirësonin duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin përmes teknikave të vlerësimit. Po ashtu me përdorimin e këtyre teknikave, mësimdhënësi informohet me saktësi për të arriturat e nxënësve dhe hapat që duhet t'i ndërmarr drejt qëllimeve të të nxënësve të nxënësve të jenë të suksesshëm.

Fjalët kyçe: vlerësim formativ, bashkëpunimi, vlerësimi i ndërsjellë, vetëvlerësim, vlerësimi i mësimdhënësit, vlerësim përmes testit etj.

3. ENEIDA KALLABA

“Qëndrimet e mësimdhënësve të shkollës fillore për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në klasa gjithëpërfshirëse”

Komisioni

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor

Prof. Ass. Ardita Devolli, kryetare

Prof. Asoc. Majlinda Gjelij, anëtare

ABSTRAKT

Sistemi i arsimit në Kosovë i është nënshtruar reformave në të gjitha nivelet: nga edukimi parashkollor e deri në nivelin universitar. Në mesin e këtyre reformave vlen të veçohet arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla të rregullta. Gjithëpërfshirja si një fenomen relativisht i ri për vendin tonë po përcillet me shumë pengesa dhe sfida, por një nga sfidat kryesore të dokumentuara rezultojnë të jenë qëndrimet që shoqëria jonë ka ndaj atyre që cilësohen me aftësi ndryshe. Si një nga elementet më të rëndësishme dhe përcaktuese për vijueshmëri të suksesshme të procesit të gjithëpërfshirjes janë qëndrimet e mësimdhënësve.

Marrë parasysh faktin që gjithëpërfshirja tashmë është bërë parim i të gjitha politikave arsimore të MASHT-it dhe arsimimi i nxënësve me nevoja të veçanta mbrohet me ligj dhe akte të tjera ligjore, ne si hulumtues kemi qenë të interesuar të dimë se çfarë mendojnë mësimdhënësit për arsimimin e kësaj kategorie të nxënësve në shkolla të rregullta.

Ky studim ka për qëllim që të identifikojë *“Qëndrimet e mësimdhënësve të shkollës fillore për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në klasa gjithëpërfshirëse”*.

Hulumtimi është i tipit sasior. Popullacion i këtij studimi janë mësimdhënësit e SHFMU të Komunës së Prizrenit dhe Suharekës. Mostrën e hulumtimit e përbëjnë 154 mësimdhënës të tetë shkollave të përzgjedhura. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur si instrument anketa me mësimdhënësit.

Rezultatet e këtij hulumtimi janë produkte të ndërtuara nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga respondentët. Rezultatet e këtij hulumtimi vënë në pah qëndrimet e mësimdhënësve të shkollës fillore të cilët janë deklaruar pro gjithëpërfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta në klasë të rregullta.

Fjalët kyçe: *gjithëpërfshirje, mësimdhënës, nxënës me nevoja të veçanta, qëndrime, shkollë.*

4. ALBERITA TAHIRI

“Qëndrimet e mësimdhënësve ndaj çrregullimeve emocionale e të sjelljes dhe efektit të tyre në të nxënë”

Komisioni

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor

Prof. Ass. Ardita Devolli, kryetare

Prof. Ass. Teuta Danuza, anëtare

Abstrakti

Studime të shumta sugjerojnë se çrregullimet emocionale dhe të sjelljes janë të lidhura negativisht me arritjet akademike. Braktisja e shkollës, rezultatet e ulëta akademike, abuzimi me substanca, papunësia janë aspekte që prekin këta nxënës, e që pastaj ka ndikim të madh edhe në shoqëri. Prandaj, qëllimi ishte që përmes këtij hulumtimi të shohim qëndrimet e mësimdhënësve ndaj çrregullimeve emocionale e të sjelljes dhe efektit që kanë në procesin e të nxënit. Hulumtimi u drejtua nga pyetjet: Cilat janë qëndrimet e mësimdhënësve për ndikimin e çrregullimeve emocionale e të sjelljes në procesin e të nxënit? Deri në çfarë mase ndikojnë çrregullimet emocionale dhe të sjelljes në suksesin akademik të nxënësve? Cilat janë pengesat më të mëdha në procesin e të nxënit? Deri në çfarë mase përfshihen fëmijët me çrregullime emocionale dhe të sjelljes në aktivitetet të cilat organizohen në klasë? Si hipotezë kryesore e këtij hulumtimi është: Çrregullimet emocionale dhe të sjelljes kanë më shumë gjasë që të kenë ndikim negativ në procesin e të nxënit se sa ndikim pozitiv. Hipoteza1: Nxënësit me çrregullime emocionale dhe të sjelljes ka më shumë gjasë të kenë rezultate me të ulta akademike se sa nxënësit e tjerë. Hipoteza2: Nxënësit me çrregullime emocionale dhe të sjelljes ka më shumë gjasë të përfshihen më pak në aktivitete me shokët/shoqet se sa nxënësit e tjerë.

Metodologjia e hulumtimit është sasiore. Instrumenti matës për mbledhjen e të dhënave është pyetësori, i cili është realizuar me një mostër prej 150 mësimdhënësve të shkollave fillore (mësimdhënës të ciklit fillor I-V) në komunën e Skënderajit. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se çrregullimet emocionale e të sjelljes kanë një ndikim negativ në procesin e të nxënit, dhe se gjithëpërfshirja e tyre në shkolla të rregullta ka ndikim pozitiv në aspektin akademik dhe social.

Fjalët kyçe: *arritjet akademike, çrregullimet emocionale, çrregullimet e sjelljes, qëndrimet e mësimdhënësve.*

5. REMZIJE HAJDINI

“Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me testin e maturës të lëndëve profesionale në raport me ato të përgjithshme”

Komisioni:

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor

Prof. Dr. Demë Hoti, kryetar

Prof Asoc. Blerim Saqipi, anëtar

Abstrakti

Provimi i maturës shtetërore është proces i një rëndësie të veçant për nxënësit përmes të cilit synohet të bëhet vlerësimi i nxënësve në njohuritë e fituara nga shkolla e mesme.

Ky hulumtim analizon e përshkruan qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me testet e maturës të lëndëve profesionale në raport me ato të përgjithshme. Mostër janë: Mësimdhënësit, interviste me fokus grup, pyetësorët si dhe me analizë të rezultateve të testeve të viteve 2016/2017/2018. Për këtë hulumtim është përdorë metoda e përzier, sasiore dhe cilësore prej pyetësorëve, që ka mundësuar përgjigjen në pyetjet lidhur me temën. Për mbledhjen e të dhënave sasiore janë përdorë pyetësorët për mësimdhënës, dokumentacioni pedagogjik i testeve të maturës. Ndërsa për mbledhjen e të dhënave cilësore është përdorë interviste me fokus grupi prej shtatë anëtareve me regjistrim në telefon me video si dhe testet e nxënësve. Të dhënat sasiore janë analizuar me metodën statistikore përmes programit excel. Hulumtimi është realizuar në komunën e Prishtinës. Në hulumtim janë përfshirë 120 mësimdhënës në shkollat përkatëse të hulumtimit.

Rezultatet do të jenë produkte të ndërtuara nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të mbledhura nga mësimdhënësit. Kjo temë më ka shty që të hulumtoi për arsye se cdo vit po përsëriten të njëjtat gjëra rreth rezultateve të nxënësve në tetse të arritshmërisë. Ky studim nxjerr përfundimin se reformat nga institucionet përkatëse së arsimit si MASHT, DKA, dhe Qeveria duhet të marrin për bazë ankesat e mësimdhënësve se ku janë shkaqet e prekshme për nivelin e tanishëm të rezultateve jo të kënaqshme.

Fjalët kyçe: *Qëndrime të mësimdhënësve, test, matura shtetërore, gjimnaze, shkolla profesionale, rezultate.*

6. VALENTINA ABDULLAHU

“Sfidat e përfshirjes aktive të fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione parashkollore” Komisioni:

Prof. Asoc. Naser Zabeli, mentor
Prof. Ass. Ardita Devolli, kryetare
Prof. Ass. Rozafa Ferizi Shala, anëtare

Abstrakti

Vitet e para të jetës së fëmijëve cilësohen si vitet më të rëndësishme të zhvillimit të tyre. Në shumë vende në zhvillim raportohet se gjithëpërfshirja është bërë tashmë një realitet, por i shoqëruar me vështirësi dhe sfida të shumta, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijët me nevoja të veçanta. Nga literatura argumentojmë se edukatorët përballen me një shumëllojshmëri sfidash, por fatmirësisht e kuptojnë arsimin gjithëpërfshirës në nivel të kënaqshëm, megjithëse disave u mungojnë aftësitë dhe njohuritë specifike për metodat adekuate të mësimdhënies për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta.

Qëllimi i këtij studimi ishte identifikimi i sfidave me të cilat ballafaqohen edukatorët ndaj përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore, e një çështje tjetër ishte gjithashtu të zbulohet se cilat janë qëndrimet e edukatoreve ndaj arsimit gjithëpërfshirës në përgjithësi. Për më tej, qëllimi i studimit është eksplorimi i përvojave dhe vështirësive të edukatoreve, por edhe nëse ka ndikuar përvoja në qëndrimin e tyre ndaj arsimit gjithëpërfshirës. Çështje tjetër e studimit është të gjej se çfarë trajnimesh kanë ndjekur edukatorët dhe sa janë plotësuar me njohuri përmes trajnimeve.

Qasja metodologjike për këtë studim është metoda cilësore kualitative. Pesëmbëdhjetë edukatore me përvojë parashkollore në qytetin e Podujevës janë intervistuar duke përdorur intervista gjysmë të strukturuar dhe dy fokus grupe me gjithsej 6 pyetje dhe disa nën pyetje.

Rezultatet tregojnë se edukatorët e kuptojnë si definicion arsimin gjithëpërfshirës, por zbatimi i tij në praktikë sipas tyre nuk është ende në nivel të kënaqshëm, në të kundërtën edukatorët shprehën pro gjithëpërfshirjes, ndërsa rekomandojnë për një bashkëpunim më të thellë ndërmjet të gjithë faktorëve të përfshirë për një gjithëpërfshirje të mirëfilltë.

Fjalët kyçe: *edukim parashkollor, fëmijë me nevoja të veçanta, gjithëpërfshirje, institucion parashkollor, sfidat e edukatoreve.*

7. FERDEZE AGAJ

“Cilësia e trajnimeve në qendrat për aftësim profesional dhe ndikimi i tyre në tregun e punës”

Komisioni:

Prof. Ass. Dr. Teuta Danuza, mentore

Prof. Asoc. Naser Zabeli, kryetar

Prof. Dr. Demë Hoti, anëtar

ABSTRAKTI

Arsimi dhe aftësimi profesional cilësohet si një nga faktorët kryesorë të zhvillimit socio-ekonomik të shoqërisë në Kosovë. Sigurimi i cilësisë në arsim dhe aftësim profesional duhet të jetë një nga prioritetet kryesore për qeverinë dhe shoqërinë civile. Pritshmëria për një performancë më të mirë në cilësinë e mësimdhënies, aftësimin praktik dhe aktiviteteve tjera të ngjashme, i detyron përgjegjësit për menaxhimin dhe administrimin e qendrave për aftësim profesional të rishikojnë strategjitë e tyre. Për këtë arsye, kërkesat për cilësi në arsimin dhe aftësimin profesional po rriten. Në këtë studim, ne shtrojmë problemin e identifikimit dhe implementimit të hapave konkretë, që bëjnë të mundur sigurimin e cilësisë në Qendrat për Aftësim Profesional, (QAP) në Republikën e Kosovës, si dhe ndikimin e tyre në tregun e punës, duke ditur se cilësia e trajnimeve në QAP, luan një rol të jashtëzakonshëm në sigurimin e tregut të punës për punëkërkuarit. Rëndësia e këtij studimi, qëndron në faktin që do të ndihmojë vendimarrësit në nivel menaxherial, për të kuptuar rëndësinë që ka validimi i kualifikimeve në planifikimet e Qendrave për Aftësim Profesional si dhe në marrjen e vendimeve. Qasja e përdorur në këtë hulumtim është sasiore dhe cilësore, pra kemi të bëjmë me metodologji mikse, ku përmes pyetësorëve dhe intervistave gjysëm të strukturuar janë mbledhur të dhënat nga shtatë (7) Qendrat për Aftësim Profesional (QAP), që gjenden në: Prishtinë, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Populacioni i këtij hulumtimi përbëhet nga stafi i Qendrave për Aftësim Profesional (QAP) siç janë: Udhëheqës, Koordinatorë për sigurim të cilësisë, trajnerë dhe kandidatë që ishin në trajnime. Përzgjedhja e mostrës është bërë përmes stratifikimit bazuar në karakteristikat e përbashkëta të stafit të QAP, dhe është bërë zgjedhja e rastësishme brenda kandidatëve. Analiza e të dhënave është bërë përmes programit SPSS dhe fokusi ka qenë në të dhënat e fituara nga Qendrat për Aftësim Profesional (QAP) si studim rasti. Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se kualifikimet e validuara në QAP kanë ndikim në ngritjen e sigurimit të cilësisë, nivel të kontrollit dhe performancës si dhe ekziston një lidhje pozitive me tregun e punës, por që nuk është e rëndësishme.

Fjalët kyçe: Trajnime cilësore, Standarti, Korniza Kombëtare e Kualifikimit, Tregu i punës.

8. MIMOZA MUSA-SELMANI

Titulli: “Bashkëpunimi mësimdhënës-prind: Përmirësimi i sjelljes dhe suksesit në shkollë të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes”.

Komisioni:

- 1. Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli - mentore**
- 2. Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli - kryetar**
- 3. Prof. Ass. Dr. Teuta Danuza - anëtare**

ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është të evidentojë rolin, rëndësinë dhe ndikimin e bashkëpunimit mësimdhënës-prind, me fokus të veçantë në përmirësimin e sjelljes dhe suksesit në shkollë të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

Hulumtimi është realizuar përmes metodës sasiore, ndërsa mostrën e përbënë 8 drejtor, 115 mësimdhënës dhe 200 prindër, të moshave dhe të gjinive të ndryshme në shkollat fillore të qytetit të Gjilanit, mostra është e qëllimshme kjo për shkak të qëllimit të hulumtimit dhe si instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësi. Të gjitha të dhënat statistikore janë përpunuar me anë të programit SPSS, të cilat janë prezantuar në tabela dhe figura përkatëse.

Rezultatet e këtij hulumtimi treguan se bashkëpunimi i prindërve dhe mësuesit ka rol, ndikim dhe rëndësi në përmirësimin e sjelljes dhe suksesit në shkollë të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes, si faktor i pazëvendësueshëm për efektet pozitive që sjellin tek këta nxënës.

Nga rezultatet e të tria grupeve pjesëmarrëse shohim që ato janë shumë bashkëpunuese me njëra tjetrën, si dhe bashkëpunimin e shohin të rëndësishëm dhe si ndihmë për menaxhim të sjelljeve të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

Rezultatet e hulumtimit dëshmojnë se mësimdhënësit dhe prindërit përdorin metoda të ndryshme dhe të përshtatshme për përmirësimin e sjelljes dhe suksesit në shkollë të nxënësve me çrregullime emocionale dhe të sjelljes.

Prindërit mund të përfshihen në shkollë dhe në shtëpi duke krijuar marrëdhënie të shëndetshme prind-fëmijë përmes kujdesit dhe mbështetjes ndaj tyre, duke qenë në çdo hap me ta. Mësuesit mund të përfshihen duke nxitur marrëdhënie të kujdesshme mësues-nxënës, duke krijuar një mjedis shkollor ku nxënësit me çrregullime emocionale mund të marrin udhëzime adekuate. Bashkëpunimi pozitiv i prindërve dhe mësuesve mund të shërbejë si mbrojtje për nxënësit me çrregullime emocionale dhe të sjelljes, ata mund t'i ndihmojnë fëmijët në krijimin e suksesit dhe rezultateve pozitive të jetës.

Fjalët kyçe: Bashkëpunimi mësimdhënës-prind, çrregullimet emocionale dhe të sjelljes, nxënës, përmirësim i sjelljes, sukcesi në shkollë.

9. MIRJETA REXHA

“Bashkëpunimi familje-edukatore përkitazi me punën me fëmijët me sjellje agresive”.

Komisioni:

- 1. Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli - mentore**
- 2. Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli - kryetar**
- 3. Prof. Ass. Dr. Teuta Danuza - anëtare**

ABSTRAKTI

Ky punim është një hulumtim kuantitativ, qëllimi i të cilit është të konstatojë se në çfarë niveli është bashkëpunimi mes prindërve dhe edukatoreve në lidhje me vështirësitë që i hasin edukatoret në punën me fëmijët me sjellje agresive.

Mostër për këtë hulumtim kemi përfshirë 100 edukatore nga institucionet parashkollore dhe 100 prindër. Të gjitha edukatoret ishin të gjinisë femërore, ndërsa prindërit ishin 72 femra dhe 28 meshkuj. Edukatoret e anketuara ishin nga komuna e Prishtinës, ndërsa prindërit ishin nga komunat: Prishtinë, Lipjan, Skenderaj dhe Viti.

Instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur pyetësoi, ku kemi hartuar dy të tillë, një për prindër dhe një për edukatore. Pyetjet në pyetësor janë parashtruar me qëllim të ofrimin e përgjigjeve të pyetjeve hulumtuese dhe vërtetimin e hipotezave. Pyetësoi për prindër përmban gjithsej 14 pyetje, prej tyre 11 janë të mbyllura dhe 3 janë të hapura. Ndërsa pyetësoi për edukatore ngërthen në vete gjithsej 21 pyetje, prej tyre 18 janë të mbyllura dhe 3 janë të hapura.

Analizimi i të dhënave dhe vërtetimi i hipotezave është bërë përmes programit SPSS (version 21). Për analizimin e të dhënave kam përdorur analizën e frekuencës, analizën deskriptive, Crosstabulation dhe analizën e One Sample T-test. Përmes analizës One Sample T-test kemi bërë vërtetimin e hipotezës së parë, e cila tregon se edukatoret bashkëpunojnë shumë me prindërit për të përmirësuar sjelljet agresive të fëmijëve (Mean =2.83; Sig. (2-tailed) = ,000). Hipotezën e dytë e kemi vërtetuar përmes analizës së frekuencës dhe shohim se 44% e edukatoreve kanë shumë vështirësi në menaxhimin e procesit të punës, kur në grup kanë fëmijë me sjellje agresive. Po ashtu edhe përmes pyetjes së gjashtëmbëdhjetë në pyetësorin për edukatore është vërtetuar hipoteza e tretë, ku tregon se edukatoret përdorin një mori teknikash (veprimesh) me qëllim të përmirësimit të sjelljeve agresive tek fëmijët e nivelit parashkollor.

Fjalët kyçe: Bashkëpunimi, edukatoret, prindërit, sjellja agresive, shkolla.

10. MERITA KEQMEZI

“Faktorët që ndikojnë në motivimin e mësimitdhënësve në shërbim për zhvillim profesional të vazhdueshëm”

Komisioni:

Prof.Asoc. Majlinda Gjellaj- mentore

Prof. Asoc. Blerim Saqipi- kryetar

Prof. Hatixhe Ismajli- anwtare

ABSTRAKTI

Zhvillimi profesional për mësimitdhënësit është gjerësisht i njohur si një mjet thelbësor për reforma në arsim. Hulumtime të shumta vërtetojnë se zhvillimi profesional mund të përmirësojë cilësinë dhe efektivitetin e mësimitdhënies dhe nxënies. Motivimi i mësimitdhënësve për të marrë pjesë në avancimin e tyre profesional është një tregues i rëndësishëm në shpjegimin e efektivitetit të atyre programeve. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte gjetja e faktorëve kryesorë që motivojnë mësimitdhënësit në shërbim për zhvillim të tyre profesional, sipas këndvështrimit të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave. Kështu me anë të pyetësorit me mësimitdhënës dhe intervistës gjysmë të strukturuar me drejtorë të shkollave, u mblodhën të dhënat lidhur me faktorët motivues që ndikojnë në zhvillim profesional të mësimitdhënësve si: faktorët motivues të brendshëm, faktorët motivues të jashtëm, faktorët në nivel shkolle si dhe faktori lidhur me efikasitetin e mbarëvajtjes së procesit mësimitdhënës.

Metodologjia e këtij hulumtimi ishte mikse (kuantitative dhe kualitative), ashtu që për mbledhjen e të dhënave sasiore u përdorën pyetësorët me mësimitdhënës, kurse me drejtorët e shkollave intervista gjysmë e strukturuar. Në hulumtim morën pjesë gjithsej 155 mësimitdhënës dhe 6 drejtorë të shkollave të komunës së Kamenicës. Pas analizimit të dhënave të grumbulluara dhe rezultateve të fituara u arrit që të vërtetohet hipoteza kryesore e hulumtimit se: Faktorët e shumtë motivues, në veçanti përkrahja nga ana e drejtuesit të shkollës, luajnë rol të rëndësishëm për motivimin e mësimitdhënësve në shërbim për zhvillim profesional dhe në angazhimin maksimal të tyre në punë. Faktori i brendshëm motivues ishte faktori që më së shumti i motivon mësimitdhënësit për zhvillim profesional.

Fjalët kyçe: Faktorë motivues, zhvillim profesional, mësimitdhënës, drejtues të shkollave, efikasitet në mësimitdhënie.

11. FISNIK KRASNIQI

“Niveli i zhvillimit të njohurive, shkathtësive dhe vlerave tek studentët absolutentë në universitetet të cilat përgatisin mësimdhënës”

Komisioni:

Prof.Asoc. Majlinda Gjellaj- mentore

Prof. Asoc. Blerim Saqipi- kryetar

Prof.Asoc. Naser Zabeli- anëtar

ABSTRAKTI

Duke e ditur që mësimdhënësit po përballen me një dinamikë të lartë të sfidave të cilat shpesh janë komplekse e për t'i zgjidhur ato duhet të jenë krijues e kreativ, atëherë vihet në pah edhe rëndësia e njohurive që mësimdhënësit duhet t'i kenë rreth tematikave që duhet të përballen me to, shkathtësitë që duhet t'i zotërojnë e përmes së cilave do të ballafaqohen me sfidat para vetës dhe vlerat të cilat duhet të jenë të panegociueshme e konstante gjatë gjithë procesit. Qëllimi i këtij hulumtimi është që të matet perceptimi i studentëve mbi nivelin e zhvillimit të këtyre njohurive, shkathtësive dhe vlerave tek studentët që janë në përfundim të studimeve themelore (bachelor) në Fakultetin e Edukimit. Studentët që synojnë të bëhen mësimdhënës duhet të kenë qasje në informata globale, të punojnë në harmoni grupore, të prodhojnë zgjidhje për probleme të ndryshme dhe të jenë përdorues të teknologjisë gjatë procesit të mësimdhënies. Këta studentë duhet të jenë inovativ gjatë përballjes me sfida, të zhvillojnë vlera etike e të jenë të përgjegjshëm, të jenë pozitiv ndaj të mësuarit individual apo grupor, duhet të jenë të aftë të zgjidhin problemet si individ apo edhe në grup dhe duhet të kenë shkathtësi analitike për të bërë dallimin mes fakteve e miteve e gjithashtu ata duhet të kenë qëndrime pozitive ndaj përdorimit të teknologjisë në të gjitha fushat e mësimdhënies.

Hulumtimi është realizuar përmes metodës së analizës sasiore, metoda e përdorur është deskriptive (përshkruese), ndërsa si instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor me shkallën Likert i bazuar në kompetencat e mësimdhënësve sipas kornizës së BE (Bashkimit Europian) përmes të cilit është matur perceptimi i studentëve absolutentë mbi nivelin e zhvillimit të njohurive, shkathtësive dhe vlerave, studentët të cilët janë në prag të diplomimit. Për mostër ishin 200 studentë të pesë fakulteteve të edukimit në Kosovë. Analiza e të dhënave është bërë me programin SPSS, analizë nga e cila vërtetohet se studentët absolutentë para shërbimit si mësimdhënës e vlerësojnë në nivel të lartë dhe të mjaftueshëm zhvillimin e njohurive, shkathtësive dhe vlerave të fituara përgjatë studimeve në fakultet ka dallime midis perceptimeve të studentëve që synojnë të bëhen mësimdhënës dhe ka dallime signifikante në mes të uiversiteteve të ndryshme të vendit për sa i përket nivelit të zhvillimit të njohurive, shkathtësive dhe vlerave përgjatë studimeve në programet e edukimit fillor

Fjalët kyçe: *mësimdhënës, njohuri, studentë, shkathtësi, vlera.*